





Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Komuna e Vitisë
Opstina Vitina-Municipality of Vitina



ZYRA E PROKURIMIT




KONTRATË PËR FURNIZIM

Nr1 i prokurimit	657-18-265-1-2-1
Nr i brendshëm	VI657-18-003-121

TITULLI I KONTRATËS : Furnizim me material te shtypur,material reklamues dhe te gravuar për të gjitha njësitë shpenzuese

E LIDHUR NË MES TË

Operatori ekonomik	Autoriteti kontraktues
NSh VISUAL MEDIA+ VITI	KOMUNA E VITISË
Përfaqësuar nga:	Përfaqësuar nga:
Lirije Ajeti, drejtor	Fadil ABAZI, menaxher i prokurimit
 	 

¹ Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

Titulli: Furnizim me material te shtypur,material reklamues dhe te gravuar për të gjitha njësitë shpenzuese Nr. Prokurimit: VI657-18-003-121

KOMUNA E VITISË, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në një tërësi; dhe

NSH VISUAL MEDIA+ VITI, (në vazhdim "operatori ekonomik" në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për furnizimet e shënuara më poshtë: **Furnizim me material të shtypur, material reklamues dhe të gravuar për të gjitha njësitë shpenzuese** me numër identifikues: **VI657-18-003-121**

Neni 1: Lënda

Lënda e kontratës është furnizim duhet të jetë Furnizuesi i furnizimeve në vijim: **Furnizim me material të shtypur, material reklamues dhe të gravuar për të gjitha njësitë shpenzuese**

Neni 2: Çmimi

2.1 Çmimi i Planifikuar i kontratës është: **27,402.00 €**

Me fjalë: Njëzetë e shtatë mijë e katërqind e dy Euro

Kontrata fillon së implementuari nga dita nënshkrimit 20.03.2018 dhe përfundon me 19.03.2019, që nënkupton se kontrata është njëvjeqare.

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Ofruesit të Furnizimit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

2.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

Neni 3 Kushtet e dërgesës

3.1 Afati kohor për dorëzim do të jetë nga koha e lëshimit të urdhër blerjes nga ana e Autoritetit Kontraktues.

3.2 Vendi i dorëzimit të furnizimit do të jetë: **Komuna e Vitise**

Neni 4: Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

4.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Marrëveshja e kontratës;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Ofruesit të Shërbimeve, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare (Përshkrimi i Çmimeve);

4.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në rast të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër

Neni 5 Komunikimet

5.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Ofruesit të furnizimeve nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës

Titulli: Furnizim me material të shtypur, material reklamues dhe të gravuar për të gjitha njësitë shpenzuese Nr. Prokurimit: VI657-18-003-121

dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

5.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimi të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimi të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

5.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

5.4 Kjo kontratë është e përgatitur në **gjuhën shqipe** në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Ofruesin e Furnizimeve.

Për Ofruesin e Shërbimeve		Për Autoritetin Kontraktues	
Emri:	Lirije Ajeti	Emri:	Fadil ABAZI
Pozita:	Drejtor	Pozita:	Menxher i Prokurimit
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:		Data:	20/03/2018
Vula:		Vula:	

PJESA II E KONTRATES KUSHTET E PËRGJITHSHME

Neni 1 Përkufizimet

1.1 "Kontratë" do të thotë marrëveshja e lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Furnizuesit, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkuorporuar me referencë në të.

1.2 "Produktet" përkufizohen si të mira materiale që kanë vlerë ekonomike, duke përfshirë por pa u kufizuar në mallrat, artikujt, lëndët e para, makineritë dhe pajisjet, objektet në formë të ngurtë të lëngshme ose të gazshme.

1.3 "Autoriteti Kontraktues" do të thotë organizata e blerjes së mallrave, siç është e quajtur Fletën mbi të Dhënat e Tenderit.

1.4 "Furnizues" do të thotë një person fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate furnizon mallra që janë objekt i kësaj kontrate.

1.5 "Palë(t)" do të thotë nënshkruesit e kontratës.

1.6 "Inkotermet" do të thotë termat ndërkombëtare tregtare që përbëjnë rregullat e interpretimit të termave tregtare që përcaktojnë mënyrën, kostot dhe rreziqet që lidhen me transferimin e produkteve nga furnizuesi tek autoriteti kontraktues.

1.7 "Furnizim" do të thotë dorëzim i produkteve me cilësi, sasi dhe lloj të specifikuar në kontratë, si dhe të vendosura dhe paketuara në mënyrën e përcaktuar në kontratë.

Titulli: Furnizim me material te shtypur, material reklamues dhe te gravuar për të gjitha njësitë shpenzuese Nr. Prokurimit: VI657-18-003-121

	Republika e Kosovës Republika Kosova-Republik of Kosovo Komuna e Vitisë Opstina Vitina-Municipality of Vitina	
ZYRA E KRYETARIT KANCELARIJA PRESEDNIKA - PRESIDENT'S OFFICE		

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr 03/L-040 (Gazeta zyrtare nr 28/2008) dhe nenit 51.1 të Statutit të Komunës së Vitisë 02 nr 013/491 të datës 21.04.2011, Kryetari i Komunës së Vitisë, bien këtë:

V E N D I M

PËR EMËRIMIN E MENAXHERIT PËR MBIKËQYRJEN E FURNIZIMEVE SIPAS KONTRATËS: **Furnizim me material te shtypur,material reklamues dhe te gravuar për të gjitha njësitë shpenzuese; nr.VI657-18-003-121**

I.

Florent YMERI, CAKTOHET menaxher i projektit për kontratës: **Furnizim me material te shtypur,material reklamues dhe te gravuar për të gjitha njësitë shpenzuese**

II.

Menaxheri nga neni 1 i këtij vendimi ka për detyrë që të bëjë:

- Menaxhimin e furnizimit të AK, të menaxhoj obligimet e AK sipas kontratës dhe të siguroj se OE kryen kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuar,
- Të siguroj kontroll të kostove,cilësisë dhe sasisë dhe kohën e dërgesave(vonesave),
- Të siguroj arritjen e qëllimit të kontratës,fushëveprimit, spicifikacionit dhe përgjegjësit e AK dhe Furnizuesit.
- Të dorëzoj Planin e menaxhimit të kontratës dhe monitoron kontratën nga nënshkrimi deri në skadimin e saj.
- Të monitoroj furnizimet dhe pagesat e kryera nga kompania

III.

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës së Vitisë dhe menaxheri nga neni 1 i këtij vendimi.

IV.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:

1. Menaxherit,
2. Operatorit,
3. Zyrës së Prokurimit,
4. Arkivit



KRYETARI I KOMUNËS SË VITISË
 Sokol HALITI